

STATUTI  
I SHOQERISE PRIVATE ME PERGJEGJIMI TE KUFIZUAR (SHPK)  
"BULQIZA KONSTRUKSION"

Hasen Deda dhe Avni Dani, ortaksë të Shoqërisë Private "BULQIZA Konstruktion", veç nënshkrimit të kontratës së themelimit të kësaj Shoqërie, hartuan e nënshkrusn edhe statutin e saj me këtë përbajtje:

KREU I DARE

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "BULQIZA KONSTRUKSION" me seli në qytetin e Bulqizës, në përputhje me vendimin për kriimin e Shoqërisë në fjalë dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon pozitën juridike të themeluesve dho të punonjësve në Shoqëri, të dhënat me rëndësi për qarkullimin juridik, organizimin dhe objektin e veprimitari të Shoqërisë dhe çeshtje të tjera me rëndësi për punën e saj.

Neni 2

Shoqëria, sipas nenit 1 të këtij statuti, krihet me mjetet vjetake të themeluesve, me karakter prone private.

Neni 3

Shoqëria, sipas neneve 1 dhe 2 të këtij statuti, do të ushtrojë veprimitarinë e saj me emrët imia SHOQERIA PRIVATE NDËRTIMORE DHE TREJTARE "BULQIZA KONSTRUKSION" (SHPK).

Neni 4

Shoqëria ka statutin e personit juridik.

Neni 5

Sellia e Shoqërisë është në qytetin e Bulqizës, në lagjen e Re, në ish Zyrat e Ndërmarrjes së Ndërtimit Bulqizë.


Neni 6

Shoqëria ka vullën e saj. Vula ka madhësi të zakonshme dho rrithë qark saj është shkruar teksti:

SHOQERIA PRIVATE NDËRTIMORE DHE TREJTARE "BULQIZA KONSTRUKSION"  
BULQIZË (ALBANIA).

Edërsa në mesin e saj është vendosur sigla përkatëse.

Neni 7

Objekti i veprimitarisë private të Shoqërisë "Bulqiza Konstruktion" 

(SMPK) do të jetë:

Projektimi dhe zbatimi i ndërtimeve në objekte të ndryshme (ndërtimë civile, punime dhei, punime murature, betoni, betonarmeje të zakonshme, punime shembjesh, ndërtimë industriale, turistike, bujqësore, e kompletimi me instalimet e nevojshme, punime restaurimi, vepër betonarmeje të vëçanta, ujësjellës e kanalizime, etj) si dhe prodhimi e tregtimit i materialeve të ndërtimit dhe ártikujve të tjera.

#### Neni 8

Shoqëria e ushtron veprinatarinë e saj të përcaktuar në këtë statut në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për kryerjen e kësaj veprintarie Shoqëria mund të çelë degë dhe zyrat e saj të përfaqësimit në vend dhe jashtë shtetit, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me legjislacionin e vendit të huaj ku do të çelen ato.

#### Neni 9

Shoqëria e kryen veprinatarinë e saj për të realizuar fitimin, duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe të rentabilitetit.

#### Neni 10

Pjesëmarrja në Shoqëri nuk i pengon ortakët që të kenë pavarësi ligjore për veprinari të tjera dhe për të drejta të tjera të pronësisë. Ortakët që marrin pjesë në Shoqëri nuk i nënshtronhen asaj si persona.

#### Neni 11


Ortakët kanë këto të drejta kryesore:

1. Të marrin pjesë në administrimin e veprinatarisë së Shoqërisë në përputhje me kontratën dhe statutin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

2. Të marrin pjesë në rezultatet e veprinatarisë së Shoqërisë të qdo forme e sasic qëftë, në përputhje me kontratën e statutin.

3. Të marrin pjesë në organet e Shoqërisë që janë krijuar ose mund të krijohen, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

4. Të kërkojnë dhënim e të gjitha informatave që kanë të bëjnë me gjendjen produhuese e tregtare të Shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara nga Shoqëria si bilancet, llogaritë ekonomike etj.

5.   Nëbëjnë proposime dhe t'i paraqesin ato për shqyrtim përvetësuar, përgjegjësuar, si dhe shërbues.

## Neni 12

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

1. Të depozitojnë kuotën e tyre në përputhje me aktin (kontraten) e themelimit të Shoqërisë dhe me këtë statut.

2. Të marrin pjesë në administrimin e Shoqërisë në përmjet organeve të krijuara prej tyre, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve që i caktojnë ata.

3. T'i jepin Shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me securinë e veprimitarisë së saj.

4. Të kryejnë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektiveve dhe të realizimit të veprimitarisë së saj.

## Neni 13

Seicili ortak pjesën e vet të kapitalit themelor mund ta transferojë me persona të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, por me miratimin e ortakut tjetër. Projektvendimi për transferimin i njofshet Shoqërisë dhe secilit ortak. Në rast se Shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit, secili ortak brenda tre muajve nga data e këtij refuzimi, duhet të blejë ose të lejojë blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar me vlerën e përspektuar sipas rregullave të parashikuara nga neni 11 i ligjit për Shoqëritë Tregtare e Prodhuase.

KREU I DITEKushtet ekonomike

## Neni 14

Veprimitaria e Shoqërisë: realizohet në bazë të parimeve të llogarës dhëpasqyrohet në bilancet e saj.

## Neni 15

Për të bërë të mundur kryerjen e veprimitarisë së Shoqërisë është siguruar blerja e pasurisë së ish Ndërmarrjes së Ndërtimit Bulqizës dhe nga ortakët është derdhur një kapital themeltar prej 1.500.000 (një milion pesë qind mijë) lekësh, me kuota të barabarta nga të dy ortakët.

## Neni 16

Shoqëria në emër të saj është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj, por gjithmonë në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimitarisë që ajo kryen. Shoqëria mund të blejë pasuri ose të shirytojë të drejtat e tjera materiale. Ajo mund të ofrojë për garanci edhe pasuritë e saj për të marrë kredi bankare.

## Neni 17

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjerë për zhvillimin e nxitjen ekonomike të saj. Gjithashtu, disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale që mund të lindin gjatë veprimtarisë së saj mbulohen nga fonde rezervë, nga fonde të tjerë ose nga shuma suplementare, që kur dëshirojnë ata, mund t'i derdhin si ortakë.

Fitimi i realizuarë nga Shoqëria gjatë një viti ndahet ndërmjet ortakëve në përpjesëtim të drejtës.

KREU I TRETHËSAdministrimi

## Neni 18

Organ i vendimer i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve, e cila vendos me unanimitet për të gjitha çeshtjet që merr në shqyrtim, si për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, për emërimin e administratoreve dhe për shkarkimin e tyre dhe për përcaktimin e drejtimeve kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë si dhe për shkrirjen e së mylljen e saj.

## Neni 19

Asambleja e Ortakëve mblidhet me miratimin e ortakëve, duke u bërë njoftimi i rendit të ditës. Vendimet e Asamblesë janë të vlefshme me votë të barabartë nga ortakët.

## Neni 20

Organ i administrativ i Shoqërisë është administrata, që zgjidhet nga Asambleja e Ortakëve. Administratori e përfaqëson Shoqërinë kundrejtë tretëve brenda caqeve të veprimtarisë së saj dhe kryen të gjitha veprimet e administrimit në interes të Shoqërisë.

Kompetencat ekskluzive të administrarotit të Shoqërisë janë:

1. Të miratojë planet e llogaritë ekonomike pas përfundimit të tyre në kuadrin e veprimtarisë së Shoqërisë.

2. Të bëjë propozimet e nevojshme në Asamblenë e Ortakëve kur lind nevoja e ndryshimit kapitalit themelor të Shoqërisë.

3. Të përcaktojë strukturën e aparatit të Shoqërisë.

4. Të krijojë organet e tjerë të domosdoshëm për realizimin e objektivave të Shoqërisë.

5. Të propozojë në Asamblenë e Ortakëve për krijimin e njësive strukturore, filiale, degë, përfaqësi në qytete të tjerë të vendit ose

6. Të përgatisë propozimin për pushimin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe t'ia paraqesë atë për miratim Asamblesë së Ortakëve.

7. Të përzgjegjë ekspertët kontabël dhe antarët e Komisionit të Likuidimit si dhe të paraqesë për miratim propozimet në Asamblenë e Ortakëve.

8. Të sigurojë zbatimin e përpiktë të vendimeve të Asamblesë së Ortakëve.

9. Të përcaktojë numrin e punonjësve të Shoqërisë dhe pagat e tyre

10. Të: përfaqësojnë Shoqërinë përpara të tretëve në Gjykatë, në Arbitrazh dhe në organet e tjera shtetërore.

Administrator i Shoqërisë emërohet z. HASAN DEDA.

Neni 21

Veprimtaria operative e Shoqërisë administrohet nga drejtori i përgjithshëm i saj, i cili përbën organin ekzekutiv.

Drejtori i përgjithshëm, në kuadrin e kompetencave të tij, të përcaktuara në këtë statut, dhe nga vendimet e Asamblesë së Ortakëve, vepron në të gjithë sektorët e Shoqërisë për ndjekjen dhe realizimin e veprimtarisë së përcaktuar në objektin e saj.

Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë ka këto detyra kryesore:

1. Është drejtues teknik i Shoqërisë dhe kontrollon punën për zbatimin e detyrave që rrjedhin nga planet e zhvillimit ekonomiko-financiar të saj.

2. Ndjez zbatimin konkret tekniko-ekonomik të vendimeve të Asamble së Ortakëve dhe të administratorit.

3. Ndjez zbatimin e administrimit të filialeve, përfaqësive ose degëve sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

4. Nënshkruan kontratë në emër dhe për llogari të Shoqërisë, me përjashtim të atyre që lidhen direkt nga Asambleja e Ortakëve ose nga administratori.

5. Raporton para Asamblesë së Ortakëve dhe Administratorëve si dhe përgjigjet para tyre për veprimtarinë e Shoqërisës në kuadrin e kompetencave të tij.

Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë emërohet z. AVNI DANI.

KREU I KATËRTKohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë

Neni 22

Afat i veprimtarisë së Shoqërisë caktitet për një periudhë prej 10 vjetësh të njëpasnjëshëm.

KREU I PESËMarrëdhëniet e punës

Neni 23

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen në përpathje me vendimin për krijimin e Shoqërisë, legjislacionin shqiptar dhe me këtë statut.

Neni 24

Punësimi i punonjësve në Shoqëri bëhet mbi bazën e kontratës kolektive të punës. Në kontratën e punës rregullohen këto qeshje:

1. Kushtet dhe mënyra e marrëdhënieve në punë.
2. Fillimi i punës së punonjësit dhe caktimi i tij në vendim e punës.
3. Caktimi i orarit të punës dhe i ditëve të pushimit.
4. Mbrojtja në punë dhe kushtet e saj.
5. Pushimet dhe mungesat.
6. Të drejtat e detyrimet e punonjësve për zbatimin e detyrave të punës.
7. Pushimi i marrëdhënieve të punës, pagë dhe shpërbllimet e punës.

KREU I GJASHTËPërgjegjësia e punonjësve

Neni 25

Punonjësi është personalisht përgjegjës për kryerjen e punëve dhe zbatimin e detyrave me ndërgjegje, në mënyrë të ligjshme dhe profesionale.

KREU I SHTATËMbyllja e Shoqërisë

Neni 26

Veprimtaria e Shoqërisë përfunden sipas përcaktimit në aktin e themelimit ose edhe më parë, sipas propozimit të bërë nga njeri prej ortakëve, kundërshtuar dy viteve të njëpasnjëshme. Veprimtaria e saj rezultojnë tabël.

Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likuidimi.

Neni 27

Kur Shoqëria likuidohet, Asambleja e Ortakëve emëron Komisionin e Likuidimit, i cili paraqet për miratim bilancin e likuidimit të Shoqërisë. Shoqëria i jep fund veprimitarisë së saj në çastin e miratimit të bilancit të likuidimit.

Neni 28

Mjetet financiare si dhe qdo pasuri tjetër e fituar si rezultat i veprimitarisë së Shoqërisë, kur Shoqëria likuidohet, ndahet ndërmjet ortakëve në përpjesët im të drejtë, ~~mes~~ pasi të jenë bërë pagesat përfurnitorët e kreditorët.

Neni 29

Ky statut hartohet në katër kopje, nga të cilat njera kopje dorëzohet në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, kopja e dytë në Zyrën përkatëse Tatimore, kopja e tretë ruhet në Zyrën e Noterisë, ku bëhet vërtetimi notarial dhe kopja e fundit ruhet në dokumentacionin e vetë Shoqërisë.

Statuti u nënshkrua mregullisht nga ortakët themelues të Shoqërisë sot më datën 17 mars 1994.

O R T A K È T :

( Hasan Deda )

( Avni Dani )

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

N O T E R I A

Nr. \_\_\_\_\_ rep.

Nr. \_\_\_\_\_ kol.

V Ë R T E T I M

Sot, më datën 17 mars 1994 (nëntëdhjetëkatër) u paraqitën personalisht në Zyrën e Noterisë në Tiranë, para meje, Noterës ortakët themelues të Shoqërisë Private "Bulqiza Konstruksion" (SHPK), Avni Dani dhe Hasan Deda, të dy madhorë, me zotësi të plotë juridikepër të vepruar, për identitetin dhe gjeneralitetet e të cilëve u sigurova nga letërnjoftimet e tyre personale, të cilët më deklaruan sekëtë statut e kanë hartuar jashtë kësaj Zyre me dëshirën dhe vullnetin e tyre të lirë, duke e nënshkruar para meje, ndërsa unë e vërtetoj atë sipas ligjës, mbasi u binda për rregullsinë e tij.

N O T E R E :

KONTRATE  
E THEMELIMIT TE SHOQERISE PRIVATE NDERTIMORE DHE TREGETARE (SHPK)  
"BULQIZA KONSTRUKSION"

Neni 1

Bazuar në ligjin nr.7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrimin tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregëtare", themelohet Shoqëria Private Ndërtimore dhe Tregëtare (shpk) nga ortakët:

1. Hasan Deda, i biri i Xhaferrit dhe i Rahmies, lindur më 1957, banues në qytetin e Bulqizës, lagja e Re, pallati A/1, administrator i Shoqërisë.

2. Avni Dani, i biri i Rustemit dhe i Ganimetës, lindur më 1962, banues në qytetin e Bulqizës, lagja e Re, nr.17, Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë.

Neni 2

Vendqëndrimi i Shoqërisë do të jetë në qytetin e Bulqizës. Shoqëria mund të hapë edhe vendqëndrime të tjera në rrethe të tjerë, sipas shtrirjes së saj ekonomike.

Neni 3

Shoqëria ka një kohëzgjatje të veprimitarisë së saj mbi 10 vjet. Përbajtja e kontratës dhe kushtet e saj, të përcaktuara në të, do të bëhen gjithmonë me shkrim.

Neni 4

Kryerja e aktivitetit prodhues e tregëtar do të jetë:

Projektimi dhe zbatimi i ndërtimeve në objekte të ndryshme (ndërtimë civile, punime dhei, punime murature, betoni e betoarmeje të zakonshme, punime shembjesh, ndërtimë industriale, turistike, bujqësore e komplektimi me instalimet e nevojshme, punime restaurimi, vepra betoarmeje të veçanta, ujësjellës e kanalizime etj) si dhe prodhimi e tregëtimit i materialeve të ndërtimit dhe i artikujve të tjerë.

Neni 5

Në fillim të veprimitarisë ekonomiko-financiare Shoqëria disponon një kapital filiestar që përbëhet nga pasuria e ish Ndërmarrjes së Ndërtimit Bulqizë dhe një kapitali themeltar të derdhur nga ortakët në masën 1.500.000 (një milione pesëqind mijë) lekë, në përpjestim të drejtë

*MV*

*JL*

## Neni 6

Kapitali i Shoqërisë mund të shtohet sipas rritjes së veprimtarisë së saj ekonomike. Të ardhurat do të sigurohen nëpërmjet veprimtarisë private të përcaktuara në numrin 4 të kësaj kontrate.

## Neni 7

Fitimet e arritura në veprimtarinë e tyre private ortakët do t'i ndajnë në mënyrë të barabartë.

## Neni 8

Pjesëtarët në Shoqëri kanë të drejtë të japin mendime, të kontrollojnë veprimtarinë financiare që do të kryejë Shoqëria e tyre.

## Neni 9

Ortakët janë përgjegjës për çdo thyerje të rregullave ligjore, ekonomike e financiare të aktivitetit të tyre.

## Neni 10

Ortakët ka për detyrë të marrin pjesë në rreziqet e veprimtarisë së Shoqërisë deri në masën e plotë të kapitalit finanziar.

## Neni 11

Kontrata nënshkruhet nga ortakët në bazë të statutit të miratuar prej tyre për krijimin e Shoqërisë Private Ndërtimore e Tregtare "BULQIZA KONSTRUKSION" (të emërtuar me këtë emër).

## Neni 12

Këmbimi i modedhës kombëtare shqiptare në lekë në monedhë të huaj e valutë të huaj e ansjelltas do të bëhet në përputhje me kursin zyrtar që caktohet nga Bankat e Shqipërisë dhe në tregun privat të valutës.

## Neni 13

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës (kolektive dhe individualë) si dhe me dispozitat ligjore të legjisacionit shqiptar të punës.

## Neni 14

Ortakët kanë për detyrë të zbatojnë rregullat e udhëzimet e inspektoriatëve të ndryshëm (financiar, higjieno-sanitar, teknik etj.).

## Neni 15

Kontrata është e vlefshme për 10 vjet kohë, me të drejtë ri-përsëritje, ndehe për një dhjetvjeçar tjeter me miratimin e ortakëve.

## Neni 16

Secili ortak ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës brenda një viti nga paraqitja e kërkesës ndaj ortakut tjetër.

Largimi nga ortakëria nuk i shmang ortakët nga detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga statuti i Shoqërisë të miratuar prej tyre para largimit nga Shoqëria.

## Neni 17

Nosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve dhe midis tyre dhe personave të tretë fizikë apo juridikë, apo të kontraktuar nga Shoqëria, do të zgjidhen me mirëkuptim. Në fast të kundërt, ruhet e drejta e zgjidhjes së tyre në Gjykaten e Rrethit të Tiranës, sipas statutit të Shoqërisë dhe kësaj kontrate si dhe kontratës së punës, në përgjithje me legjislacionin e punës së Republikës së Shqipërisë.

## Neni 18

Kontrata është hartuar në katër kopje, në gjuhën shqipe, e cila, pasi u lexua në prani të ortakëve dhe u miratua prej tyre, nënshkruehet rregullisht pa asnjë vërejtje.

Kjo kontratë hyn në fuqi pasi nënshkruehet nga palët kontraktues. Kontrata u nënshkrua sot më datën 17 mars 1994, në Tiranë.

## ORTAKËT :

ADMINISTRATORI:

( Hasan Deda )

DREJTORI I PERGJITHSHME:

( Avni Dani )

~~REPUBLICA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
NOTERIA~~

Nr. \_\_\_\_\_ rep.  
Nr. \_\_\_\_\_ kol.

VËRTETIM

Sot, më datën 17 mars 1994 (nëntëdhjetëkatër), u paraqiten personalisht në Zyrën e Noterisë në Tiranë, para meje, Noterës, palët kontraktuese (ortakët themelues të Shoqërisë Private "BULQIZA KONSTRUKSION") Hasan Deda dhe Avni Dani, të dy madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin dhe gjeneralitetet e të cilëve u sigurova nga letërnjoftimet e tyre personale, të cilët më deklaruan se këtë kontratë të lidhur midis tyre e kanë hartuar ja shtë kësaj Zyre me dëshirën e vullnetin e tyre të plotë, të cilën e nënshkruan para meje, ndërsa unë, mbasi e gjeta të rregullt, e vërtetoj atë konformë dispozitave ligjore.

NOTERE :